



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA DURRËS
KËSHILLI BASHKIAK

VENDIM

Nr. 102, datë 30.03.2023

PËR
MIRATIMIN E LISTËS SË GJASHTËMBËDHJETË TË 8 SUBJEKTEVE
PËRFITUESE, TË CILËT DO TË PËRFITOJNË MASËN E GRANTIT TË
RINDËRTIMIT TË BANESAVE INDIVIDUALE TË DËMTUARA NGA TËRMETI I
DATËS 26 NËNTOR 2019, SIPAS PROJEKTIT MODEL

Në zbatim të Ligjit nr. 139/2015, “Për vetëqeverisjen vendore” i ndryshuar, Aktit Normativ nr. 9, datë 16.12.2019 “Për përballimin e pasojave të fatkeqësisë natyrore” miratuar me Ligjin nr.97/2019, VKM nr. 5, datë 06.01.2020 “Për përcaktimin e rregullave dhe të procedurave për përfitimet nga programi i granteve të rindërtimit dhe projektet model” i ndryshuar, VKM nr.904, datë 24.12.2019 “Për përcaktimin e rregullave, të kategorive prioritare, masës së përfitimit, autoriteteve përgjegjëse dhe procedurave për vlerësimin dhe përzgjedhjen e përfituese nga disa programe të procesit të rindërtimit”, i ndryshuar, Vendimit të Këshillit Bashkiak nr.8, datë 28.01.2021 “Për miratimin e kontratës model për kalimin e masës së grantit të rindërtimit për banesat individuale të dëmtuara nga tërmeti i datës 26 nëntor 2019 sipas projekteve model nga Bashkia Durrës tek përfituesi” dhe sipas relacionit të hartuar nga Komisioni i Posaçëm për vlerësimin dhe përzgjedhjen e përfituesve nga programet e procesit të rindërtimit, në Bashkinë Durrës, me propozim të Kryetares së Bashkisë,

KËSHILLI BASHKIAK
V E N D O S I :

1. Miratimin e listës së gjashtëmbëdhjetë të 8 subjekteve përfituese, të cilët do të përfitojnë masën e grantit të rindërtimit të banesave individuale të dëmtuara nga tërmeti i datës 26

nëntor 2019, sipas projektit model, pasqyruar në aneksin 1, bashkëlidhur këtij vendimi si pjesë përbërëse e tij, hartuar nga Komisioni i Posaçëm për vlerësimin dhe përzgjedhjen e përfituesve nga programet e procesit të rindërtimit.

2. Ngarkohen për zbatimin e këtij vendimi Zyra e Posaçme e Rindërtimit, Rikonstruksionit dhe Rimëkëmbjes Ekonomike pranë Drejtorisë së Sherbimeve, Drejtoria Ekonomike dhe Drejtoria e Planifikimit, Kontrollit dhe Zhvillimit të Territorit.

Ky vendim hyn në fuqi sipas përcaktimeve të nenit 55, pika 6, të Ligjit Nr.139/2015, “Për vetëqeverisjen vendore”, i ndryshuar.

KRYETAR I KËSHILLIT BASHKIAK

Ani Dyrmishi



U shpall sot me datë 05.04.2023

ANEKSI I. SUBJEKTET PËRFITUESE NGA MASA E GRANTIT TË RINDËRTIMIT

NR	NJESIA ADMINISTRATIVE	EMRI	ATESIA	MBIEMRI	PËRBËRJA FAMILJARE	STRUKTURA E BANESËS	VLERA E GRANTIT
1	R2	GJORCE	QIRIAKO	MARKU	4	2+1	2,617,558
2	R2	TRAJCE	QIRIAKO	MARKU	2	1+1	2,236,552
3	R5	MAJLINDA	DYLAVER	CIRAKU	3	2+1	2,617,558
4	ISHEM	XHEVAT	MAHMUT	HOXHA	5	3+1	3,428,958
5	ISHEM	PJETER	DED	BUSHI	7	3+1	3,428,958
6	ISHEM	SANIJE	ZEQIR	VELI	4	2+1	2,617,558
7	ISHEM	MUHARREM	KADRI	TEMA	7	3+1	3,428,958
8	ISHEM	ENVER	ZEQIR	HASA	5	3+1	3,428,958





REPUBLIKA E SHQIPËRISË
PREFEKTI I QARKUT DURRËS

Nr. 240 prot.
8

Durrës, më 12.04 .2023

Lënda: Verifikim i ligjshmërisë së aktit

**KËSHILLIT BASHKIAK
DURRËS
KRYETARIT TË BASHKISË
DURRËS**

Verifikova ligjshmërinë e Vendimit të Këshillit Bashkiak Durrës Nr.102 datë 30.03.2023 “Për miratimin e listës së gjashtëmbëdhjetë të 8 subjekteve përfituese, të cilët do të përfitojnë masën e grantit të rindërtimit të banesave individuale të dëmtuara nga tërmeti i datës 26 nëntor 2019, sipas projektit model”

Ky vendim në bazë të Ligjit nr 44/2015 “Kodi i Procedurave Administrative” neni 3 pika 2 nuk është akt me karakter normativ. Vendimi është akt administrativ individual bazuar në nenin 3 pika 1/a të Ligjit nr 44/2015 “Kodi i Procedurave Administrative”, pasi i drejtohet subjekteve të përcaktuar individualisht duke krijuar një marrëdhënie juridike konkrete si dhe është i shteruar në zbatimin e tij.

Në bazë të Ligjit Nr.107/2016 “Për Prefektin e Qarkut” (neni 8/a) “Prefekti i qarkut verifikon ligjshmërinë e vendimeve, urdhrave dhe urdhërësive me karakter normativ të organeve të vetëqeverisjes vendore”.

Për sa më sipër verifikimi i këtij vendimi duke qenë një akt administrativ me karakter individual **nuk është në kompetencën e Prefektit të Qarkut.**

Duke ju falenderuar për bashkëpunimin.

PREFEKTI

EMILJAN JANI

